



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E PUNËVE
TË BRENDSHME

**STRATEGJIA KOMBËTARE PËR PARANDALIMIN DHE
LUFTËN KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE
KRIMEVE TË RËNDA 2026-2030 DHE PLANI I
VEPRIMIT 2026-2028**

Tiranë, tetor 2025

TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e shkurtimeve

PJESA I: KONTEKSTI STATEGJIK	fq.1
1.1 Hyrje dhe Qëllimi	fq.2
1.2 Visioni dhe qëllimi i dokumnetit strategjik	fq.2
1.3 Metodologjia	fq.3
1.4 Analiza e riskut, arritjet dhe mësimet	fq.3
1.5 Kuadri ligjor dhe institucional në fuqi, lidhja me dokumentet dhe strategjike	fq.8
PJESA II: QËLLIMI I POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE TË DOKUMENTIT STRATEGJIK	fq.10
2.1 Qëllimi I Politikës I: Parandalimi i krimit të organizuar dhe krimeve të rënda	fq.10
Objektivi specifik: 1.1: Realizimi i fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit për parandalimin e krimit të organizuar, me përfshirjen e institucioneve qendrore dhe vendore, shoqërisë civile, biznesit, medias dhe aktorëve të tjerë	fq.11
Objektivi specifik: 1.2: Ofrimi dhe koordinimi i mbështetjes së brendshme/huaj për zona dhe komunitete vulnerabël	fq.11
Objektivi specifik: 1.3: Identifikimi dhe mbështetja e individëve në rrezik për t'iu nënshtruar shtrëngimit, dhunës dhe frikësimit nga krimi i organizuar	fq.12
Objektivi specifik 1.4: Rritja e profesionalizmit	fq.12
Objektivi specifik 1.5: Dobësimi i motivit financiar në përfshirje në krimt të organizuar	fq.13
2.2 Qëllimi I Politikës II: Ndjekja penale dhe goditja e krimit të organizuar dhe krimeve të rënda	fq.14
Objektivi specifik 2.1: Krijimi i një mjedisi të sigurt për shoqërinë përmes uljes së ofertës dhe mundësive për përdorim të paligjshëm të narkotikëve	fq.14
Objektivi specifik 2.2: Goditja e trafikëve të paligjshme	fq.15
Objektivi specifik 2.3: Përmirësimi i efikasitetit në luftën kundër krimit ekonomik dhe financiar, pastrimit të parave, korrupsionit dhe të ardhurave nga krimi	fq.16

Objektivi specifik 2.4: Hetimi i krimeve kibernetike	fq.17
Objektivi specifik 2.5: Krijimi i një qasje strategjike për një shërbim forensik të akredituar që garanton integritetin e provës në sistemin e drejtësisë	fq.18
Objektivi specifik 2.6: Qasje strategjike mbi procesin e identifikimit, gjurmimit, konfiskimit të aseteve me prejardhje kriminale dhe ripërdorimit të tyre	fq.19
Objektivi specifik 2.7: Hetimi, ndjekja penale dhe dënimi i drejtuesve dhe anëtarëve të strukturave kriminale	fq.20
Objektivi specifik 2.8: Forcimi i parandalimit, zbulimit dhe ndëshkimit të krimit mjedisor duke zbuluar grupet e organizuara në aktivitete kriminale ndaj mjedisit, si dhe uljen e ndjeshme të rasteve të ndotjes së qëllimshme, prerjes ilegale të pyjeve dhe trafikimit të mbetjeve të rrezikshme si dhe shkatërrimit të shtretërve të lumenjve	fq.21
Objektivi specifik 2.9: Kapja e personave në kërkim ndërkombëtar	fq.22
2.3 Qëllimi I Politikës III: Bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar	fq.24
Objektivi specifik 3.1: Forcimi i bashkëpunimit policor ndërkombëtar	fq.24
Objektivi specifik 3.2: Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja	fq.25
PJESA III: ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, RAPORTIMI DHE MONITORIMI	fq.25
3.1. Përgjegjësia e Institucioneve	fq.25
3.2. Llogaridhënia, raportimi dhe monitorimi	fq.25
PJESA E IV: ANALIZA BUXHETORE	fq.26

LISTA E SHKURTIMEVE

AAPSK	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
AKSK	Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike
AIMS	Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes
AIF	Agjencia e Inteligjencës Financiare
AMF	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
AS	Akademia e Sigurisë
BE	Bashkimi Evropian
BKH	Byroja Kombëtare e Hetimit
BSH	Banka e Shqipërisë
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DVP	Drejtore të Vendore të Policisë
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
EUDA	Agjencia e Drogave e Bashkimit Evropian
EMPACT	Platforma multidisiplinare evropiane kundër kërcënimeve kriminale
FAST	Njësia për Kapjen e Personave në Kërkim
FATF	Task-Forca e Veprimit Financiar
GKO	Grupet e krimit të organizuar
IKRTK	Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore
IAL	Institucione të Arsimit të Lartë
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KLGI	Këshilli i Lartë Gjyqësor
MA	Ministria e Arsimit
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme

MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MEI	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit
MM	Ministria e Mbrojtjes
MTKS	Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
MM	Ministria e Mjedisit
PP	Prokuroria e Përgjithshme
PU	Policia Ushtarake
QKEDH	Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SIENA	Aplikacioni i sigurt i rrjetit të shkëmbimit të informacionit
SKKOKR	Strategjia kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda
SHISH	Shërbimi Informativ i Shtetit
SPAK	Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

1. HYRJA DHE QËLLIMI I DOKUMENTIT STRATEGJIK

Krimi i organizuar përbën një nga kërcënimet më serioze për sigurinë kombëtare, rendin publik dhe zhvillimin demokratik të një shteti. Ai shfaqet në forma të ndryshme, duke përfshirë trafikun e drogës, trafikimin e qenieve njerëzore, krimin financiar, pastrimin e parave dhe korrupsionin, shpesh herë të ndërlidhura me rrjete ndërkombëtare kriminale. Natyra dinamike dhe aftësitë e grupeve kriminale për të dëmtuar dhe sfiduar rendin publik e bën të domosdoshme hartimin e një qasje strategjike të unfikuar ndërinstucionale për t'iu përgjigjur dhe adresuar në mënyrën e duhur këto kërcënime.

Strategjia Kombëtare për Parandalimin dhe Luftën kundër Krimin të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2026–2030 përfaqëson një qasje të avancuar, të integruar dhe të drejtuar nga inteligjenca ndaj sfidave komplekse të sigurisë që lidhen me format më të sofistikuara dhe të ndërlidhura të krimin të organizuar dhe krimeve të rënda në Shqipëri. E ndërtuar mbi përvojën e strategjisë ndërsektoriale të mëparshme për periudhën 2020-2025 dhe Planeve të saj të Veprimit, kjo strategji shënon një riorientim të plotë drejt përparësive aktuale dhe prioritetëve afatgjatë të shtetit shqiptar në luftën kundër krimin të organizuar.

Zbatimi i Strategjisë Kombëtare kundër Krimin të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2026 – 2030 është me rëndësi parësore për të gjithë qytetarët e Republikës së Shqipërisë dhe shënon një hap të rëndësishëm të shtetit shqiptar në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Në këtë kontekst, nëpërmjet implementimit të këtij dokumenti strategjik, Republika e Shqipërisë përcakton prioritetet e saj politike në fushën e ndërtimit të një sistemi efikas për luftën kundër krimin të organizuar dhe krimeve të rënda, duke specifikuar qëllimet kryesore strategjike, objektivat specifike si dhe përgjegjësitë e autoriteteve shtetërore përkatëse. Gjithashtu, dokumenti strategjik krijon bazat e nevojshme që bëjnë të mundur identifikimin e Shqipërisë në sferën rajonale, evropiane dhe globale si një aktor të besueshëm në luftën kundër krimin të organizuar dhe krimeve të rënda.

Strategjia është në harmoni të plotë me Programin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024 – 2026, dhe është e lidhur konceptualisht me dokumentet e tjerë strategjikë të Republikës së Shqipërisë që trajtojnë aspektet e luftës kundër korrupsionit, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, trafikimit të armëve dhe qenieve njerëzore, sigurisë në komunitet dhe menaxhimit të integruar të kufijve.

Ky kuadër i ri strategjik garanton përputhje të plotë me angazhimet e ndërmarra nga institucionet shqiptare në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës – Kapitulli 24 “Drejtësia, Liria dhe Siguria” dhe adreson në mënyrë koherente gjetjet e Komisionit Evropian për Grupkapitullin e

Parë “Themeloret” mbi hapat e nevojshëm për të përmirësuar performancën e Shqipërisë në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda.

Hartimi i Strategjisë së Re është mbështetur në një analizë të plotë të arritjeve dhe sukseseve të arritura gjatë implementimit të Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021 – 2025, e cila ka shërbyer si një udhëzues i nevojshëm për vijimin e reformave të iniciuara tashmë si dhe për përcaktimin e objektivave të rinj për periudhën në vijim, të reflektuar tashmë në dokumentin e ri strategjik. Gjithashtu hartimi i kësaj strategjie është rezultat i një procesi gjithëpërfshirës dhe transparent konsultimi ndërmjet institucioneve publike, agjencive të zbatimit të ligjit, sistemit të drejtësisë, aktorëve të shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Në vitet e fundit, Shqipëria ka shënuar përparime të dukshme në luftën kundër krimit të organizuar, duke intensifikuar operacionet policore, përmirësuar kapacitete hetimore dhe rritur bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë. Arrestimi i elementëve kryesorë të botës së krimit, çmontimi i grupeve kriminale dhe sekuestrimi e konfiskimi i aseteve kriminale të tyre përbëjnë dëshmi konkrete të këtij progresi. Strategjia e re synon të konsolidojë këto arritje dhe të vendosë një bazë të fortë për një qasje të qëndrueshme dhe të koordinuar në luftën kundër krimit të organizuar.

1.2 VIZIONI I STRATEGJISË

Strategjia kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda do të shërbejë si udhërrëfyes për mobilizimin e të gjitha strukturave për t’iu kundërpërgjigjur grupeve dhe individëve kriminalë, duke harmonizuar ndërveprimin midis qeverisë, sektorit privat, komunitetit dhe qytetarëve dhe vizioni i saj është si vijon:

“Garantimi i një mjedisi të sigurt për zhvillimin e vendit dhe të shoqërisë nga kërcënimet e krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, duke siguruar jetën e individit, sipërmarrjen e lirë dhe respektimin e ligjshmërisë në tërësi”

Ky vizion është në përputhje dhe harmoni të plotë me Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrimin, ku lufta kundër krimit të organizuar lidhet konkretisht me shtyllën e parë të SKZHIE 2030 “Demokracia e fuqizimi i institucioneve dhe qeverisjes së mirë”, në të cilën parashtrohet nevoja e forcimit të mëtejshëm të institucioneve efikase të vendit si bazë që siguron demokracinë, konkurrencën dhe zhvillimin ekonomik të vendit duke e përgatitur atë për anëtarësim në “familjen e madhe” të Bashkimit Evropian.

Në këtë shtyllë është parashikuar lufta kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe trafikimit si një ndër komponentët përbërës të saj.

Sfidat që ka parashikuar kjo strategji lidhen gjithashtu me sfidat e parashtruara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrimin Evropian 2030 “Garantimi i një mjedisi të

sigurt për zhvillimin e vendit dhe të shoqërisë nga kërcënimet e krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, duke siguruar jetën e individit, sipërmarrjen e lirë dhe respektimin e ligjshmërisë në tërësi”.

1.3 METODOLOGJIA

Procesi i hartimit të kësaj strategjie është zhvilluar, mbi bazën e një metodologjie të integruar në kuadër të Planit Kombëtar të Integrimit Evropian (PKIE) 2024-2026, si dhe angazhimeve përkatëse në kuadër të procesit të Berlinit dhe mekanizmave të monitorimit të BE-së dhe OKB-së.

Dokumenti është hartuar përmes një procesi gjithëpërfshirës konsultimi, i koordinuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, si institucion përgjegjës për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike, në të gjitha fazat e tij, duke nisur nga analiza e riskut deri te miratimi përfundimtar. Ky proces është zhvilluar në bashkëpunim me institucionet e tjera relevante, si strukturat e varësisë të Ministrisë së Punëve të Brendshme (Policia e Shtetit, AAPSK), Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Mbrojtjes, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministria e Mjedisit, Ministria e Arsimit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Pasurive Kulturore, Shërbimi Informativ Shtetëror, Banka e Shqipërisë, Prokuroria e Përgjithshme, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Shoqëria Civile, OJQ dhe Organizma Ndërkombëtarë (EU4LEA, ICITAP, Këshilli i Evropës, Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri), media.

Gjatë hartimit të strategjisë krahas infrastrukturës ligjore, programeve të ndryshme shtetërore, në analizën për vlerësimin e situatës aktuale dhe identifikimin e prioriteteve dhe objektivave për të ardhmen, janë marrë në konsideratë dhe praktikatat më të mira të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe partnerëve ndërkombëtarë, rekomandimet dhe gjetjet e progres-raporteve të Komisionit Evropian dhe mekanizmat e monitorimit të kapitullit 24 (Drejtësia, Liria dhe Siguria), Komitetit të Stabilizim-Asocimit, GRETA-s, të Task Forcës për Veprim Financiar (FATF), të Grupit të Punës për Masat kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (ICRG) dhe të Departamentit Amerikan të Shtetit (DASH) etj., duke i dhënë dokumentit një bazë të gjerë për zbatimin sa më efektiv të tij.

1.4 ANALIZA E RISKUT, ARRITJET DHE MËSIMET

Shqipëria ka shënuar progres në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, i evidentuar dhe në raportet e vlerësimet periodike të kryera nga organizmat ndërkombëtarë.

Konkretisht në raport progresin e Komisionit Evropian për vitin 2024 përcaktohet se *“Shqipëria ka bërë përparime në luftën kundër krimit të organizuar duke rritur kapacitetet e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, duke përmirësuar përdorimin e hetimeve paralele financiare dhe duke amenduar kuadrin ligjor mbi substancat psikotrope.”*

Një tjetër tregues thelbësor i rezultateve pozitive të arritura, është dhe nxjerrja e Shqipërisë nga “lista gri” e FATF-së në lidhje me fushën e zbatimit të masave kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

Shqipëria ka përditësuar kuadrin ligjor dhe strategjik në këtë fushë duke mundësuar në këtë mënyrë krijimin e një infrastrukture të përshtatshme institucionale dhe operative, rritjen e kapaciteteve të specializuara për luftën kundër krimit të organizuar dhe zhvillimin e analizës kriminale dhe hetimeve të bazuara në inteligjencë.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar krijimit dhe funksionimit të strukturave të koordinimit dhe bashkëpunimit ku përmendet ngritja e Zyrës së Rekuperimit të Aseteve, operacionalizimi i Njesisë së Informacionit të Pasagjerit apo dhe organizimi i Sistemit për Paralajmërimin e Hershëm mbi Substancat e Reja Psikoaktive në linjë me rekomandimet e Bashkimit Evropian.

Në luftën kundër narkotikëve, në fillim të vitit 2024, Këshilli i Ministrave miratoi amendimin e ligjit nr. 7975, datë 26.07.1995 *“Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”*, të ndryshuar duke realizuar në këtë mënyrë përditësimin e tabelave të klasifikimit të barnave narkotike dhe lëndëve psikotrope, sipas parashikimeve më të fundit të Bordit Ndërkombëtar të Kontrollit të Narkotikëve dhe duke bërë të mundur ndryshimin e dispozitave përkatëse lidhur me përdorimin e bimës së *cannabis-it* për qëllime industriale dhe mjekësore.

Gjithashtu, struktura e re e Policisë së Shtetit, e miratuar në vitin 2023, solli shtimin dhe përmirësimin e kompetencave hetimore të Departamentit të Policisë Kriminale duke bërë të mundur profilizimin e tyre me qëllim rritjen e efikasitetit hetimor dhe goditjen e grupeve kriminale.

Përmirësimet në kuadrin procedural, infrastrukturën fizike dhe teknologjike kanë qenë vendimtare për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, rajonal dhe ndërkombëtar. Kjo ka bërë të mundur krijimin e ekipeve të përbashkëta hetimore (JITS) për luftën kundër trafikimit, veçanërisht trafikimit të drogës, dhe ka mundësuar bashkëpunim operacional e shkëmbim efektiv të informacionit me partnerët ndërkombëtarë si Guardia di Finanza, Europol, Interpol, EMPACT dhe EUROJUST.

Shqipëria është vendi i parë, jo anëtar i Bashkimit Evropian, që ka vendosur njësi të FRONTEX në territorin e saj. Nisja e Operacionit të Përbashkët me Agjencinë Evropiane të Rojës

Kufitare dhe Bregdetare, FRONTEX, që prej majit 2019, në kufirin juglindor të Shqipërisë ka pasur një ndikim pozitiv në menaxhimin e migracionit të parregullt në vendin tonë. Një rezultat i parë pozitiv nga ky operacion ka qenë forcimi i kapaciteteve njerëzore dhe logjistike për monitorimin e zonës kufitare. Si pasojë e kësaj, identifikimi i migrantëve të parregullt në pikat hyrëse përgjatë kufirit ka shënuar një rritje të dukshme, nga 40% e të gjitha rasteve në vitin 2019 në 90-95% në vitin 2023.

Sa i përket sfidave, nisur nga pozicioni i favorshëm gjeografik si pjesë e rajonit të Ballkanit, i cilësuar si udhëkryq për kalimin drejt Evropës, Republika e Shqipërisë mbetet e rrezikuar nga aktivitete kriminale të strukturuar kryesisht në fushën e trafikimit të lëndëve narkotike, trafikimit të paligjshëm të migrantëve si dhe qenieve njerëzore. Një element i rëndësishëm i evidentuar kohët e fundit është përdorimi gjithnjë e më i madh i mjeteve teknologjike dhe platformave online për të lehtësuar kryerjen e aktiviteteve kriminale, duke krijuar mundësi të reja dhe më efikase për organizimin dhe funksionimin e grupeve kriminale.

Shtimi i fluksit të lëvizjes së migrantëve të paligjshëm, të ardhur kryesisht nga rajoni i Lindjes së Mesme dhe Afrikës së Veriut nxiti grupet kriminale në Shqipëri për ofrimin e asistencës për kalimin e paligjshëm të kufirit dhe trafikimin e migrantëve. Veprimtaria e individëve/rrjeteve të kontrabandës së emigrantëve konsistonte më së shumti në lehtësimin e hyrjes dhe lëvizjes nga Greqia në Shqipëri, akomodimin dhe transportimin e tyre brenda territorit të Shqipërisë, me qëllim kalimin e tyre drejt vendeve të Bashkimit Europian. Metodat dhe pajisjet e sofistikuara të përdorura nga grupet kriminale ishin kryesisht për sigurimin e dokumenteve të falsifikuara për qëllime të udhëtimit të paligjshëm drejt vendeve të BE-së përmes pikave të kalimit kufitar ajror dhe detar.

Sa i përket trafikimit të lëndëve narkotike, me përjashtim të lëndës së *cannabis-it*, ku Shqipëria është vend origjine, në kategoritë e tjera të lëndëve narkotike duke përmendur këtu lëndët e heroinës dhe kokainës, Shqipëria rezulton si vend tranzit. Sasitë e lëndëve narkotike të destinuara për tregun e brendshëm janë të vogla dhe pjesa më e madhe kalon tranzit nëpër territorin e Shqipërisë, me destinacion vendet e BE-së. Në vitet e fundit, është zgjeruar aktiviteti i trafikimit të kokainës, e prodhuar në vendet e Amerikës së Jugut (Kolumbi, Ekuador dhe Brazil), e transportuar në rrugë detare drejt Portit Detar të Durrësit për të vijuar më pas drejt vendeve të Bashkimit Evropian.

Kohët e fundit është identifikuar një trend rritës në përdorimin e kriptomonedhave për pagesa në tregun e lëndëve narkotike duke mundësuar në këtë mënyrë fshehjen e gjurmëve financiare si dhe përdorimi i rrjetit DarkWeb për të shpërndarë lëndët narkotike duke ruajtur në këtë mënyrë anonimitetin e shpërndarësve të këtyre lëndëve.

Një tjetër aspekt i cili kërkon një vëmendje të shtuar për trajtimin e tij është dhe fenomeni i pastrimit të parave me prejardhje nga aktivitete kriminale të ndryshme. Në ditët e sotme kur globalizimi dhe teknologjia kanë përshpejtuar transaksionet ndër-kufitare dhe kanë krijuar mundësi

të reja për zhvillim, në horizont është shfaqur një kërcënim gjithmonë e në rritje: transaksionet e paligjshme financiare dhe krimet financiare që lidhen me to. Këto përfshijnë një gamë të gjerë aktiviteteve kriminale, të tilla si pastrimi i parave, evazioni fiskal, korrupsioni, trafikimi i drogës dhe trafikimi i qenieve njerëzore, të cilat shpesh u mundësojnë organizatave kriminale dhe terroriste të financojnë operacionet e tyre.

Disa nga format e rrezikut të pastrimit të parave të identifikuar në Shqipëri janë:

- Pastrimi i fondeve nga një sërë veprash penale të kryera jashtë vendit (vepra penale të lidhura me trafikimin e lëndëve narkotike, apo edhe vepra penale të kryera nga krimi i organizuar, vjedhja e pasurisë) nëpërmjet përdorimit të sistemit financiar formal, transportit ndërkufitar të parave cash, investimeve në pasuri të paluajtshme;
- Pastrimi i fondeve nga mashtrimet (përfshirë mashtrimet kompjuterike dhe në fushën e investimeve në “platforma” investuese të pa licencuara), të kryera jashtë vendit ose në Shqipëri nga individë apo grupet e organizuara kriminale përmes përdorimit të sistemit financiar me pasojë transferimin e fondeve në juridiksione të tjera ose tërheqjen në para cash;
- Pastrimi i fondeve nga krimet që lidhen me fushën e tatimeve (fshehja e të ardhurave dhe mashtrimi i TVSH), duke përdorur personat juridik rezident, duke mos deklaruar bilance dhe faturimet reale, nëpërmjet regjistrimit të personave juridik që nuk kryejnë aktivitete real në Shqipëri (shoqëri fiktive), nëpërmjet përdorimit të sistemit financiar formal, investimeve në pasuri të paluajtshme;
- Pastrimi i të ardhurave nga korrupsioni përmes përdorimit herë pas here të palëve të treta (individë dhe persona juridik) që shërbejnë për të kamufluar mekanizmin, integrimi i mëvonshëm në instrumente financiare, pasuri të paluajtshme brenda vendit, apo biznese;
- Pastrimi i parave duke përdorur persona juridikë rezident (kryesisht të formës shpk dhe më rrallë forma të tjera juridike) ose persona të tretë individë brenda ose jashtë rrethit të ngushtë të personit që është gjenerues i të ardhurave kriminale.

Sektorët ekonomikë të përdorur më shpesh për aktivitete të pastrimit të parave janë: Sektori i Pasurive të Paluajtshme, Ndërtim, Tregtia, Sektori i Shërbimeve Telematike (Call Center), Konsulenca në fushën ekonomike dhe ligjore. Rast pas rasti, skemat e pastrimit të parave përfshijnë dhe elementë ndërkombëtarë të krijuara qëllimisht apo edhe përfshirje të bizneseve ekzistuese, elementë të cilat synojnë të pengojnë identifikimin, gjurmimin e burimit dhe qëllimin përfundimtar të përdorimit të të ardhurave kriminale.

Sa i përket kanaleve të përdorimit, analizat dhe vlerësimet e kryera të riskut kanë identifikuar se kanalet më të përdorura për pastrimin e parave janë sistemi bankar dhe kategoritë e profesioneve të caktuara jofinanciare. Ky rezultat bazohet në disa aspekte si natyra e ekonomisë në vendin tonë e cila përfshin kategori subjektsh tradicionalë dhe të përqendruar kryesisht në

sektorin bankar, ndërkohë që subjektet e tjera financiare janë ende me zhvillim minimal krahasuar me bankat.

Përdorimi i sistemit bankar është përgjithësisht i pashmangshëm në një apo më shumë faza të pastrimit të parave (vendosja, shtresëzimi, integrimi), për shkak kjo të natyrës së qenësishme të operacionit bankar, zhvillimit të tij dominues në vendin tonë krahasuar me subjekte të tjera financiare, madhësisë dhe rëndësisë së tij, si dhe për shkak të numrit të madh të klientëve apo transaksioneve të kryera në emër të tyre. Ndërsa sektori bankar në parim ka një ekspozim të lartë ndaj rreziqeve të pastrimit të parave, vlerësohet se ka ndërgjegjësim të mirë dhe mjete të përshtatshme dhe për t'i zbuluar ato. Kjo është konfirmuar përveçse nga vlerësimet ndërkombëtare të fushës edhe nga një nivel i lartë raportimi të RAD ndër vite jo vetëm në nivel numerik por edhe sa i përket cilësisë së tyre. Kështu si indicie për informacionet e dërguara nga AIF në organet ligjzbatuese në mbi 90% të rasteve kanë shërbyer RAD e dërguara nga sektori bankar.

Profesioni i noterit është perceptuar dhe ka rezultuar edhe nga të dhënat si ndër më të cënueshmet krahasuar me subjektet/profesionet e tjera për shkak se noteri në Shqipëri ka një rol qendror, si dhe kryen një gamë të gjerë të veprimeve juridike (huadhënie, kontrata kredie, çelje trashëgimie etj.), për pjesën më të madhe e të cilave është mundësia e vetme për veprimet, përfshirë këtu edhe transaksionet e pasurive të paluajtshme.

Produktet më të përdorur për pastrimin e produkteve të veprës penale bazuar në analizë janë: transfertat hyrëse/dalëse me dhe nga jashtë vendit, tërheqje/depozitim i fondeve, transferimi i fondeve brenda vendit.

Lidhur me përdorimin e transfertave bankare ndër karakteristikat që i bëjnë ato tërheqëse për rastet e pastrimit të parave janë: vështirësia për të monitoruar ose kontrolluar transfertat elektronike, në nivel të njëjtë me produkte të tjera bankare për shkak të vëllimit të transaksioneve; fondet mund të transferohen përmes juridiksioneve të ndryshme, në mënyrë që të humbasin gjurmët e burimit të fondeve, apo transferimet mund të bëhen nga një numër i madh llogarish bankare në depozitat që janë krijuar për të humbur gjurmët e llogarisë kryesore shpesh të vendosur jashtë vendit.

Për sa i përket përdorimit të parasë cash ndër karakteristikat që i bëjnë ato tërheqëse për rastet e pastrimit të parave janë: fshehja e origjinës së të ardhurave dhe vështirësinë në gjurmimin e këtyre të ardhurave.

Në përgjithësi, aktivitetet e trafikimit të lëndëve narkotike, vepra penale të kryera në formën e krimit të organizuar, krimet tatimore, korrupsioni, mashtrimi (duke përfshirë mashtrimin kompjuterik) shfaqen si vepra penale kryesore të gjenerimit të fondeve për skemat e pastrimit të parave në vendin tonë

Me zhvillimet e fundit teknologjike, krimet kibernetike kanë evoluar ndjeshëm duke u paraqitur si një sfidë madhore për strukturat shtetërore dhe organet ligjzbatuese. Ndër format më të përhapura të cilat janë evidentuar janë:

- *Mashtrimi kompjuterik, Phishing dhe Smishing*: Përdorimi i teknikave të phishing (dërgimi i email-eve të rreme për të vjedhur informacione personale) dhe smishing (mesazhe tekstuale të rreme për të mashtruar individët;
- *Business Email Compromise (BEC)*: Ky fenomen ka prekur shumë kompani dhe individë të pasur, ku hakerët përdorin email-e të falsifikuara për të fituar akses në sisteme financiare ose për të transferuar para në llogari të jashtme;
- *Përdorimi i AI për Deepfake*: Teknologjitë e Inteligjencës Artificiale, si deepfake përdoren për krijimin e videove dhe audio të rreme që mund të dëmtojnë reputacionin e individëve.

Në vitet e fundit, një fushë tjetër ku individë dhe grupe kriminale janë shfaqur aktiv është shfrytëzimi i burimeve natyrore, njëra prej të cilave është industria e lëndëve të para. Shqipëria ka pësuar shpyllëzime masive dhe përkeqësime si rezultat i prerjeve të paligjshme në të cilat kanë kontribuar grupe lokale të krimit të organizuar dhe zyrtarë të korruptuar. Gjithashtu, raportet e Policisë së Shtetit kanë treguar se krimet mjedisore kanë pësuar rritje në periudhën 2023 – 2025.

1.5 KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL NË FUQI, LIDHJA ME DOKUMENTET DHE PRIORITETET STRATEGJIKE

Shqipëria gëzon një kuadër të plotë ligjor dhe nënligjor, si dhe një bazë të konsiderueshme dokumentesh strategjike që adresojnë çështjet e krimit të organizuar dhe krimeve të rënda. Kuadri ligjor për luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda përfshin një tërësi ligjesh, aktesh nënligjore, që përbëjnë bazën e nevojshme rregullatore për këtë fushë. Konkretisht disa nga aktet ligjore dhe strategjike janë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë;
- Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 10192/2009 “Për eliminimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit, nëpërmes masave ndaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 44/2025 “Për Zyrën e Rekuperimit të Aseteve”;
- Ligji nr. 7975/1995 “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”;
- Ligji nr. 9917/2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10173/2009, “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”;
- Ligji nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”, i ndryshuar;

- Ligji nr. 38/2025 “Për përpunimin e informacionit të pasagjerit në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 10193/2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”;
- Ligji nr. 112/2020 “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 154/2020 “Për regjistrin qendror të llogarive bankare”;
- Ligji nr. 79/2020, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”;
- Akti Normativ nr. 1/2020, “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër Terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit publik”.
- Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës së Shqipërisë nr. 44, datë 10.06.2009 “Për miratimin e rregullores “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”;
- Ligji nr. 9910, datë 24.07.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave për Krimet e Rënda”;
- Strategjia e Sigurisë Kombëtare;
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2024–2030;
- Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2024–2030;
- Agjenda Kombëtare e Reformave 2024-2027;
- Udhërrëfyesi i Shtetit të së Drejtës për Kapitullin 23 dhe 24;
- Strategjia Ndërsektoriale për Sigurinë Publike dhe Planin e Veprimit 2024 – 2026;
- Strategjia Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftës kundër Terrorizmit dhe planet e veprimit 2023-2025;
- Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024 – 2030;
- Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Planin e Veprimit 2024 – 2030;
- Strategjia Ndërsektoriale e Menaxhimit të Integruar të Kufirit dhe plani i veprimit 2021-2027;
- Strategjia e Kontrollit për Armët e Vogla e të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve dhe plani i veprimit 2019-2025;
- Planin Kombëtar të Integritit Evropian (PKIE);
- Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2024-2030;
- Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit;
- Prioritetet e Ministrit të Punëve të Brendshme;
- Marrëveshje me EUROPOL, INTERPOL;

Gjithashtu, Shqipëria është palë e instrumenteve të rëndësishëm ndërkombëtarë që lidhen me luftën kundër krimit të organizuar, konkretisht:

- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional (UNTOC) dhe protokollat e saj shtesë:
 - o Protokolli kundër Trafikimit të Personave;
 - o Protokolli kundër Trafikimit të Migrantëve;

- Protokolli kundër Prodhimit dhe Trafikimit të Paligjshëm të Armëve të Vogla dhe Municioneve.
- Konventa Evropiane kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (GRETA);
- Konventa Evropiane e Ekstradimit dhe protokollet shtesë;
- Konventa e Këshillit të Evropës për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit (Konventa e Varshavës);
- Koalicioni Global në Përgjigje të Rreziqeve të Drogave Sintetike;
- Rregulloret dhe direktivat e BE-së në fushën e bashkëpunimit gjyqësor penal dhe policiak;
- Rekomandimet e Task-Forcës kundër Pastrimit të Parave (FATF/ICRG);
- Raportet vjetore të Departamentit Amerikan të Shtetit (DASH);
- Marrëveshjet operationale me EUROPOL dhe INTERPOL;
- Iniciativa Globale kundër Krimit të Organizuar Transnacional (GI-TOC);
- Deklaratat dhe agjendat e Procesit të Berlinit dhe Konferencave të Ministrave të Ballkanit Perëndimor mbi Sigurinë.

Lidhja e dokumentit strategjik me Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit

Lufta kundër krimit të organizuar, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së, është parashikuar në Nenet 4, 82, 84 dhe 85 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Bashkëpunimi në fushën e luftës kundër trafikeve të paligjshme, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së, është parashikuar në Nenet 4 dhe 85 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Bashkëpunimi në fushën e luftës kundër pastrimit të parave ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së, është parashikuar në Nenin 4 dhe 82 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Gjithashtu, në Nenet 5, 82 dhe 84 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit është parashikuar bashkëpunimi ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së në fushën e luftës kundër terrorizmit. Nenet 83 dhe 85 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit sigurojnë bashkëpunimin në fushën e luftës kundër drogës. Angazhimet në fushën e doganave janë marrë në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, të parashikuara në nenet 14, 15, 34, 43 dhe 97. Bashkëpunimi në fushën e çështjeve penale është përcaktuar në Nenin 85 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Lidhja e dokumentit strategjik me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

Strategjia parashikon qëllimet dhe objektivat e hartuar në kuadër të përmbushjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030 dhe Agjendës 2030, konkretisht me Objektivin 16 të Zhvillimit të Qëndrueshëm “Promovimi i shoqërive paqësore dhe përfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrim i aksesit në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet”. Ky dokument lidhet konkretisht me:

- Nënobjektivin 16.1: “Zvogëlimi i ndjeshëm kudo i të gjitha formave të dhunës dhe shkallën e vdekjeve të lidhura me to.”,

- Nënobjektivin 16.2 “T”i jepet fund abuzimit, shfrytëzimit, trafikimit dhe të gjitha formave të dhunës dhe torturës ndaj fëmijëve” si dhe;
- Nënobjektivin 16.A “Forcimi i institucioneve kombëtare relevante, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkombëtar, për ndërtimin e kapaciteteve në të gjitha nivelet, veçanërisht në vendet në zhvillim, për të parandaluar dhunën dhe për të luftuar terrorizmin dhe krimin”.

PJESA II: QËLLIMI I POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE TË DOKUMENTIT STRATEGJIK

2.1 QËLLIMI I POLITIKËS 1: PARANDALIMI I KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KRIMEVE TË RËNDA

Lufta ndaj krimit përbën një nga prioritetet kryesore të qeverisë shqiptare dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, si dhe është një ndër kriteret kryesore për procesin e anëtarësimit në BE. Konsolidimi i shtetit të së drejtës dhe rritja e sigurisë në vend janë të lidhura ngushtësisht me përmirësimin dhe harmonizimin e kuadrit ligjor me aktet e BE-së, rritjen e kapaciteteve njerëzore dhe logjistike në institucionet ligjzbatuese, garantimin e integritetit, përmirësimin e proceseve hetimore dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar.

Kjo strategji dhe plani i veprimit që e shoqëron mbështetet në vizionin e qeverisë për mbrojtjen e qytetarëve dhe përparimit të vendit nga kërcënimet dhe nuk krimet e rënda, përmes zvogëlimit të risqeve dhe rritjes së fuqisë parandaluese.

Ky dokument do të shërbejë si udhërrëfyes për zbatimin në praktikë të qasjes gjithëpërfshirëse kundër veprimtarive të paligjshme dhe strukturave të krimit të organizuar, përmes koordinimit dhe ndërveprimit efektiv midis qeverisë, sektorit privat, komunitetit dhe qytetarëve.

SKKOKR synon intensifikimin e përpjekjeve të përbashkëta për goditjen dhe shkatërrimin e grupeve kriminale dhe rrjeteve të tyre. Nëpërmjet forcimit të kapaciteteve aktuale dhe krijimit të kapaciteteve të reja do të përmirësohen proceset e gjurmimit, konfiskimit dhe sekuestrimit të aseteve dhe pasurive kriminale. Në qendër të kësaj qasjeje do të jetë aftësimi i institucioneve për nxjerrjen e të dhënave, përpunimin dhe vlerësimin e tyre, me qëllim njohjen e strukturave kriminale dhe depërtimin në to, duke shtuar në këtë mënyrë forcën goditëse dhe eficiencën në luftën ndaj tyre.

Prioritetet, objektivat dhe masat konkrete të parashikuara në këtë strategji, janë të organizuara dhe synojnë të adresojnë tre çështje kryesore në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimet e rënda: **(1) Parandalimi, (2) Goditja (3) Bashkëpunimi Kombëtar dhe Ndërkombëtar.**

Me qëllim parandalimin e krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, është e nevojshme ndërmarrja e masave të koordinuara dhe efektive që adresojnë faktorët që e favorizojnë zhvillimin e veprimtarive kriminale, duke përfshirë forcimin e kapaciteteve të institucioneve ligjzbatuese, si dhe bashkëpunimin e ngushtë ndërmjet aktorëve të ndryshëm në nivel ndërinstitucional dhe ndërkombëtar.

OBJEKTIVI SPECIFIK 1.1: Realizimi i fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit për parandalimin e krimit të organizuar, me përfshirjen e institucioneve qendrore dhe vendore, shoqërisë civile, biznesit, medias dhe aktorëve të tjerë.

Në kushtet e rritjes së rreziqeve që sjell krimi i organizuar për sigurinë kombëtare, stabilitetin ekonomik dhe shoqëror të vendit, është i domosdoshëm ndërtimi i një qasjeje të bashkërenduar dhe gjithëpërfshirëse për parandalimin e këtij fenomeni. Në funksion të përmbushjes së këtij objektiivi specifik të kësaj politike, do të zbatohen masat e mëposhtme:

- Organizimi i fushatave ndërgjegjësuere në nivel qendror dhe vendor, me grupe të targetuara dhe tema të përshtatura me kontekstin vendor lidhur me risqet, pasojat dhe parandalimin e përfshirjes në veprimtari kriminale
- Organizimi i leksioneve dhe seminareve të hapura në institucione arsimore publike dhe private
- Realizimi i video-mesazheve ndërgjegjësuere mbi risqet dhe pasojat e krimit të organizuar si dhe promovimi i modeleve pozitive ndërmjet të rinjve dhe transmetimi në mediat lokale, rrjete sociale, etj.
- Botimi i praktikave më të mira, manualeve dhe studimeve të përbashkëta në lidhje me krimin financiar, korrupsionin dhe efektet e tyre negative në shoqëri.
- Trajnime të stafëve përgjegjëse në luftën kundër trafikimit të pasurive kulturore me qëllim koordinimin, ndjekjen, shkëmbimin e përvojave dhe ideve të reja.

Në këtë kuadër, duke angazhuar të gjitha palët relevante dhe duke krijuar një bashkëpunim të fortë dhe të qëndrueshëm mes institucioneve dhe grupeve të ndryshme shoqërore, do të adresohet me efikasitet rreziku dhe pasojat që vijnë nga krimi i organizuar, ndërkohë që do të promovohet një kulturë parandalimi dhe ndërgjegjësimi në Shqipëri.

OBJEKTIVI SPECIFIK 1.2: Ofrimi dhe koordinimi i mbështetjes së brendshme/huaj për zona dhe komunitete vulnerabël ka si qëllim të sigurojë një mbështetje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme për individët dhe grupet të cilët janë të ekspozuar ndaj pasojave të aktiviteteve dhe veprimtarive të paligjshme.

Ky objektivi synon të trajtojë në mënyrë të integruar problemet sociale, ekonomike dhe ligjore që ndikojnë negativisht në jetën e komunitetit, duke u mundësuar atyre mundësi për zhvillim dhe përmirësim të kushteve të jetesës. Përmes mbështetjes adekuatë dhe krijimit të mundësive për punësim, arsim dhe shërbime sociale, synohet forcimi i kapaciteteve të këtyre

grupeve për të tejkaluar vështirësitë me të cilat përballen. Po ashtu, do të angazhohen mekanizma koordinimi midis institucioneve shtetërore, organizatave ndërkombëtare dhe grupeve shoqërore, me qëllim krijimin e një kornize ligjore dhe sociale që mundëson integrimin e këtyre individëve në jetën e përditshme dhe luftën kundër varfërisë dhe krimit.

Masat të cilat do të zbatohen për këtë objektiv janë si më poshtë:

- Evidentimi dhe analizimi i zonave gjeografike, komuniteteve dhe grupeve shoqërore të afektuara dhe vulnerabël ndaj strukturave dhe veprimtarive të paligjshme
- Nxitja e kalimit të objekteve të konfiskuara në pronësi të njësive të qeverisjes vendore me qëllim përdorimin si qëllime sociale
- Zhvillimi i takimeve ndërgjegjëse mbi procedurat e kalimit të pronave të konfiskuara nga aktiviteti kriminal tek institucionet qendore dhe vendore
- Trajtimi i të burgosurve në aspektin psikosocial, kulturor dhe kushtet e ambienteve dhe infrastrukturës së burgjeve, si dhe hartimi dhe jetësimi i programeve sociale dhe trajnimeve apo kurseve profesionale.
- Hartimi i analizave dhe studimeve në bashkëpunim me Akademi të Sigurisë, specialistëve të fushës, psikologë dhe shoqërisë civile, për të analizuar arsyet, shkaqet dhe faktorët që çojnë në vrasje, si dhe të jepen mendimet dhe mundësitë për zgjidhjen e problematikave, dhe luftimi i shkaqeve që çojnë në vrasje.

Gjithashtu, do të vijojnë nxitjet e programeve sociale me fokus tek shtresat në nevojë, duke destinuar asetet e konfiskuara për krijimin e mundësive zhvillimi dhe përmirësimin e kushteve të jetesës, me qëllim dekurajimin e tyre për përfshirje në aktivitete kriminale.

OBJEKTIVI SPECIFIK 1.3: Identifikimi dhe mbështetja e individëve në rrezik për t'iu nënshtruar shtrëngimit, dhunës dhe frikësimit nga krimi i organizuar.

Në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, autoritetet ligjzbatuese duhet të zotërojnë kapacitet për të garantuar sigurinë dhe jetën e dëshmitarëve të cilët janë të ekspozuar ndaj kërcënimeve serioze, si dhe viktimat e trafikimit, për të mundësuar atyre të kotribuojnë në proceset e drejtësisë pa patur frikë për jetën.

Në këtë kuadër, është thelbësore që institucionet ligjzbatuese të mundësojnë garantimin e jetës dhe integritetit të këtyre individëve, duke përfshirë krijimin e programeve të mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve, si dhe të mundësohet përmirësimi i sistemeve të ndihmës dhe rehabilitimit për viktimat e krimeve të rënda dhe trafikimit. Në këtë mënyrë, do të rritet edhe besimi i qytetarëve në institucionet shtetërore dhe do të forcohet marrëdhënia shtet-qytetar. Për përmbushjen e këtij objektiivi duhet të zbatohen masat e mëposhtme:

- Garantimi i jetës dhe sigurisë fizike të dëshmitarëve, bashkëpunëtorëve të drejtësisë, funksionarëve të ngarkuar me luftën kundër krimit të organizuar dhe viktimave të trafikimit.
- Nënshkrimi i marrëveshjeve me njësitë homologe për rialokimin jashtë të programeve të mbrojtjes me qëllim përforcimin e mekanizmave të sigurimit të jetës së bashkëpunëtorëve dhe dëshmitarëve të drejtësisë.

OBJEKTIVI SPECIFIK 1.4: Rritja e profesionalizmit

Në një kohë kur krimi i organizuar vazhdon të gjejë forma të reja dhe më të sofistikuara për të operuar, duke përfshirë pastrimin e parave dhe veprimtaritë ilegale në shumë aspekte, rritja e profesionalizmit të institucioneve ligjzbatuese është një nevojë dhe prioritet strategjik. Për të mundësuar një luftë më efektive ndaj krimit, është e domosdoshme që shërbimet e rendit, organet e prokurorisë, dhe gjykatave të zotërojnë njohuri të thella, teknologji moderne dhe kapacitete të avancuara për hetime dhe procedura ligjore. Ky profesionalizëm duhet të shtrihet jo vetëm në nivelin e njohurive teknike, por edhe në aftësinë për të menaxhuar sfidat e reja që lindin nga zhvillimet e shpejta në teknologji dhe metodat e krimit.

Për të arritur këtë, është e nevojshme që të investohet në trajnimet e vazhdueshme, zhvillimin e kapaciteteve, si dhe shkëmbimin e eksperiencave me partnerët ndërkombëtarë. Njëkohësisht, duhet të forcohen mekanizmat e mbikëqyrjes dhe përgjegjshmërisë brenda institucioneve ligjzbatuese, me qëllim që të parandalohet çdo mundësi për keqpërdorim të pushtetit dhe të sigurohet se ligji zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjithë. Rritja e nivelit të profesionalizmit do të përmirësojë jo vetëm efikasitetin e institucioneve, por do të krijojë gjithashtu besim më të madh të qytetarëve tek drejtësia dhe ligji, duke mundësuar një klimë më të sigurt dhe më të drejtë për shoqërinë. Me qëllim arritjen rezultateve pozitive në këtë drejtim, do të zbatohen masa dhe aktivitete si më poshtë:

- Reformimi i Policisë Kriminale dhe vlerësimi i pozicionimit të strukturave të mbrojtjes së dëshmitarëve, ENFAST, strukturat e bashkëpunimit ndërkombëtar, strukturat e krimit kibernetik;
- Rritja e kapaciteteve investiguese ndaj krimit të organizuar, krimit ekonomik e financiar të punonjësve të PSH-së;
- Rekrutimi i punonjësve në shërbim të policisë gjyqësore;
- Profilizimi i programve të Akademisë së Sigurisë dhe edukimi i punonjësve të PSH-së në luftën e krimit të Organizuar, përmes Akademisë së Sigurisë;
- Trajnimi i oficerëve të policisë gjyqësore për hetimin e veprave penale financiare, për të hetuar krimin financiar, pastrimin e parave dhe trafikimin;
- Kryerja e trajnimeve të strukturave të hetimit të krimit në Policinë e Shtetit mbi format dhe metodat më të avancuara të hetimit të strukturave dhe veprimtarive kriminale;
- Zhvillimi i takimeve ndërgjegjësuere me prokurorët për të rritur përdorimin e rrjetit të pikave të kontaktit 24/7 të krijuar nga Konventa e Këshillit të Evropës për Krimin Kibernetik;

- Kryerja e trajnimeve të stafit në çdo pikë të kontrollit kufitar lidhur me përdorimin e Bazës së të Dhënave Shtetërore “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)” .

OBJEKTIVI SPECIFIK 1.5: Dobësimi i motivit financiar në përfshirje në krimin e organizuar

Krimi i organizuar mbështet në përfitime të mëdha financiare për të bërë të mundur vijimin e ushtrimit të aktiviteteve kriminale ndaj dhe goditja e motiveve financiare përbën një ndër aspektet themelore të luftës kundër krimit të organizuar për shkak se demotivon individët për t’u përfshirë në aktivitete kriminale duke ju përcjellë mesazhin e qartë se askush nuk del i fituar nga përfshirja në krim. Në këtë mënyrë, është e nevojshme zhvillimi efektiv i masave specifike për të adresuar mundësitë për konfiskimin e aseteve kriminale dhe ripërdorimin e tyre, duke u fokusuar kryesisht në ripërdorimin social të tyre.

Disa nga masat kryesore që do të shërbejnë për përmbushjen e këtij objekti janë:

- Ndërmarrja e procesit të kryerjes së analizës së vlerësimit kombëtar të rrezikut nga Krimi Organizuar dhe grupet e strukturave kriminale;
- Rritja e kontroleve të realizuara bazuar në vlerësimin e rrezikut në luftimin e ekonomisë joformale, evazionit tatimor dhe shmangies tatimore;
- Rritja e veprimeve të koordinuara (kontroll/inspektim) në bizneset me rrezik të lartë lidhur me pastrimin e prave;
- Kontrolli i mallrave që kategorizohen me rrezik të lartë të shmangies së taksave;

QËLLIMI I POLITIKËS II: NDJEKJA PENALE DHE GODITJA E KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KRIMEVE TË RËNDA

OBJEKTIVI SPECIFIK 2.1: Krijimi i një mjedisi të sigurt për shoqërinë përmes uljes së ofertës dhe mundësive për përdorim të paligjshëm të narkotikëve

Ky objektiv synon të ndërmarrë masa të efektshme dhe të koordinuara për forcimin e kontrollit dhe monitorimit të aktiviteteve të dyshimta që lidhen me trafikimin dhe shpërndarjen e lëndëve narkotike. Për të arritur këtë qëllim, është element thelbësor krijimi dhe zhvillimi i një bashkëpunimi të ngushtë dhe të vazhdueshëm midis agjencive kombëtare të zbatimit të ligjit, institucioneve të sigurisë dhe organeve hetimore, si dhe partnerëve ndërkombëtarë që veprojnë në fushën e luftës kundër narkotikëve. Ky bashkëpunim do të mundësojë shkëmbimin e informacionit të nevojshëm në kohë reale, koordinimin e operacioneve të përbashkëta dhe ndarjen e praktikave më të mira, duke rritur kështu kapacitetin e përgjithshëm për të goditur rrjetet kriminale që operojnë në këtë sektor.

Në kuadër të këtij objekti, do të vijojë procesi i reformimit dhe fuqizimit të sistemit ligjor dhe atë institucional, me qëllim funksionimin efikas të mekanizmave dhe strukturave të avancuara për identifikimin, ndjekjen dhe parandalimin e veprimtarive kriminale lidhur me lëndët narkotike. Këtu bën pjesë përmirësimi i kuadrit ligjor për t'iu përshtatur sfidave të reja dhe vendimeve të Komisionit të Drogave Narkotike, si dhe forcimi i kapaciteteve të strukturave përgjegjëse për monitorimin dhe hetimin e këtyre veprimtarive. Gjithashtu, është parashikuar investimi në teknologji dhe trajnime të specializuara për punonjësit e strukturave përgjegjëse, duke rritur aftësinë për të zbuluar dhe ndërprerë zinxhirët e shpërndarjes së drogës, duke siguruar një përgjigje më të shpejtë dhe më efektive ndaj këtij fenomeni kompleks. Në këtë mënyrë, strategjia synon të krijojë një sistem të qëndrueshëm dhe efikas në luftën kundër narkotikëve, që do të kontribuojë në ruajtjen e sigurisë dhe shëndetit publik. Disa nga masat që synojnë realizimin e këtij objekti janë:

- Goditja e veprimtarive kriminale në fushën e narkotikëve përmes veprimtarisë zbuluese të udhëhequr nga inteligjenca dhe evidenca në fushën e narkotikëve;
- Përditësimi i bazës së të dhënave të posaçme për kultivimin e bimëve narkotike me informacione nga të gjitha burimet e mundshme vendase dhe të huaja;
- Rritja e koordinimit ndërinstitutional me SPAK, Prokurori në funksion të operacioneve të përbashkëta me qëllim të rritjes së zbulimit, hetimit, ndjekjes penale, dhe sekuestrimit në fushën e lëndëve narkotike;
- Rritja e hetimeve proaktive për veprat penale në fushën e narkotikëve;
- Monitorimi dhe kontrolli i territorit në parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike;
- Konsolidimi i kapaciteteve dhe procedurave mbi shkëmbimin informacioneve mes Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm dhe Observatorit të Drogave për shkëmbimin e informacionit për substancat e reja psikotrope;
- Ngritja e Observatorit të Drogave;
- Miratimi i akteve nënligjore të ligjit nr. 61/2023 për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së cannabis-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale;
- Rastet e devijimeve të sasive të mbjella të kanabisit të evidentuara nga mbikëqyrja dhe monitorimi i zbatimit të lejeve ose licencave, përfshirë vendimet për asgjësimin e tyre dhe sanksionet përkatëse;
- Forcimi i bashkëpunimit me strukturat përgjegjëse për doganat për monitorimin e importit dhe eksportit të farërave e të fidanëve dhe të nënprodukteve ose produkteve përfundimtare të cannabis-it mjekësor dhe industrial;
- Shkëmbimi i informacionit të mbledhur në kuadër të ligjit nr. 61/2023 me autoritetet kompetente në funksion të identifikimit të prodhimit të paligjshëm, trafikimit të narkotikëve dhe substancave psikotrope, dhe ndaj pastrimit të të ardhurave prej aktivitetit të paligjshëm me lëndët narkotike.

OBJEKTIVI SPECIFIK 2.2: Goditja e trafikeve të paligjshme

Një fokus i veçantë në këtë strategji i kushtohet reduktimit të kërcënimeve që rrjedhin nga veprimtaritë e paligjshme në fusha të ndryshme të trafikeve, të cilat paraqesin sfida të mëdha për sigurinë kombëtare dhe rendin publik. Këto përfshijnë trafikimin e qenieve njerëzore, një krim që shkel në mënyrë të drejtpërdrejtë të drejtat dhe dinjitetin e njeriut, si dhe ndihmën për kalim të paligjshëm të kufirit, i njohur ndryshe si kontrabandimi i migrantëve, që ka pasoja serioze humanitare dhe ligjore. Përveç këtyre, strategjia adreson edhe trafikimin e armëve, municioneve dhe lëndëve plasëse, fenomene që rrezikojnë sigurinë publike dhe stabilitetin në rajon. Po ashtu, një rëndësi të madhe i jepet luftës kundër trafikimit të veprave të artit dhe pasurive kulturore, që përbën jo vetëm një humbje të madhe për trashëgiminë kombëtare, por edhe një sfidë në nivel ndërkombëtar.

Për t'u përballur me këto kërcënime, strategjia parashikon zbatimin e masave dhe veprimeve të specializuara, të cilat do të jenë pjesë e planit të veprimit, i cili do të përcaktojë konkretisht mënyrat, përgjegjësitë dhe burimet e nevojshme për efektivitetin e tyre. Kjo do të përfshijë forcimin e kapaciteteve hetimore dhe operacionale të agjencive ligjzbatuese, ngritjen e bashkëpunimit ndërinstytucional dhe ndërkombëtar, si dhe përdorimin e teknologjive moderne për monitorimin dhe goditjen e këtyre rrjeteve kriminale. Për më tepër, do të theksohet edhe rëndësia e ndërgjegjësimit dhe edukimit publik për të mbështetur përpjekjet ligjzbatuese dhe për të krijuar një mjedis më rezistent ndaj këtyre formave të krimit të organizuar. Në këtë mënyrë, strategjia synon të ndërtojë një qasje gjithëpërfshirëse dhe të koordinuar për të minimizuar ndikimin dhe përhapjen e trafikeve të paligjshme në të gjitha format e tyre. Ulja e kërcënimeve dhe e ndikimit negativ që shkaktohet nga veprimtari të trafikeve të paligjshme do të mbështetet në realizimin e masave dhe aktiviteteve të mëposhtme:

- Rritja e veprimtarisë zbuluese ndaj trafikeve të paligjshme përmes udhëhequr nga inteligjenca dhe evidenca dhe metodat speciale të hetimit;
- Rritja e kontrollit kufitar për parandalimin dhe goditjen e trafikimit ndërkombëtar të drogave;
- Rritja e numrit të patrullimeve të policisë Kufitare me qëllim luftimin e kontrabandës;
- Rritja e bashkëpunimit me partnerët në drejtim të zbulimit të veprimtarive të paligjshme dhe goditjes së strukturave kriminale në fushën e trafikeve të paligjshme dhe kundër trafikimit të qenieve njerëzore;
- Rritja e hetimeve të Policisë së Shtetit në operacionet kundër trafikimit të armëve të zjarrit dhe municioneve;
- Rritja e kontrollit kufitar për parandalimin dhe goditjen e trafikimit të mjeteve motorike;
- Rritja e kontrollit kufitar për parandalimin dhe goditjen e trafikimit ndërkombëtar të pasurive kulturore;
- Hartimi dhe miratimi i Planit Kombëtar të Veprimit "Për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të pasurive kulturore të luajtshme", për vitet 2023-2025;
- Krijimi i databazës së Objekteve të Humbura, vënia në funksion e saj, si dhe përditësimi i bazës së të dhënave dhe Regjistrit Kombëtar të Pasurive Kulturore;

- Hartimi dhe miratimi i një udhëzimi për procedurat e përditësimit të bazës së të dhënave dhe administrimit të pasurive kulturore të vjedhura, në zbatim të pikës 6 të nenit 130 të Ligjit 27/2018.

OBJEKTIVI SPECIFIK: 2.3 Përmirësimi i efikasitetit në luftën kundër krimit ekonomik dhe financiar, pastrimit të parave, korrupsionit dhe të ardhurave nga krimi

Edhe pse Shqipëria ka arritur progres të dukshëm në luftën kundër krimit të organizuar, krimit ekonomik dhe financiar, si dhe në parandalimin dhe goditjen e pastrimit të parave dhe korrupsionit, sfidat në këto fusha mbeten të mëdha dhe komplekse. Për këtë arsye, strategjia kombëtare do të vazhdojë të përqendrohet në përmirësimin e vazhdueshëm të efikasitetit të politikave ekzistuese, duke synuar konsolidimin e rezultateve të arritura dhe zgjerimin e kapaciteteve në luftën kundër krimit ekonomik dhe pastrimit të parave. Për ta arritur këtë, do të ndërmerren masa të shumta që përfshijnë forcimin e kapaciteteve institucionale dhe teknike të agjencive të zbatimit të ligjit, rritjen e bashkëpunimit dhe koordinimit me institucionet e drejtësisë, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar, si dhe krijimin e mekanizmave më të avancuar dhe inovativë për identifikimin, gjurmimin dhe konfiskimin e të ardhurave të përfituara në mënyrë të paligjshme.

Për më tepër, strategjia do të përqendrohet në zhvillimin e kuadrit ligjor dhe rregullator në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare, duke mundësuar një përgjigje më të shpejtë dhe më efektive ndaj fenomeneve të pastrimit të parave dhe krimit ekonomik. Do të intensifikohet përdorimi i teknologjive të avancuara dhe mjeteve analitike për të monitoruar lëvizjet financiare të dyshimta dhe për të zbuluar shfrytëzimin e sistemeve financiare për aktivitete kriminale. Një rëndësi e veçantë do t'i kushtohet ngritjes së kapaciteteve të stafit përmes trajnimeve të specializuara, që do të fuqizojnë aftësinë për hetime të thelluara dhe për ndjekje penale efektive.

Për të arritur rezultate të qëndrueshme, strategjia parashikon thellimin e bashkëpunimit me sektorin privat dhe institucionet financiare, duke përfshirë bankat, institucionet e pagesave elektronike dhe entet e tjera financiare, për të përmirësuar mekanizmat e raportimit dhe verifikimit të transaksioneve të dyshimta. Një fokus i rëndësishëm do të jetë edhe në rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe edukimin mbi rreziqet dhe pasojat e krimit ekonomik dhe pastrimit të parave, për të krijuar një mjedis më të përgjegjshëm dhe më rezistent ndaj këtyre fenomeneve. Për këtë qëllim disa nga masat të cilat janë formuluar në këtë seksion janë:

- Goditja e pastrimit të parave të udhëhequr nga inteligjenca (hetime proaktive, analiza risku dhe me metoda speciale hetimi);
- Identifikimi i rasteve të moszbatimit të kërkesave ligjore për pastrimin e parave nga operatorët privatë (bankat, zyrat e këmbimit valutor, institucionet financiare jo banka, fondet e pensionit,

- noterët, avokatët, firmat e ndërtimit, lojërat e fatit, kazinotë, audituesit ligjorë, kontabilistët e miratuar, agjentët e pasurive të paluajtshme etj.) dhe sanksionet përkatëse të ndërmarra;
- Zgjerimi i aksesit në Bazën qendrore të Monedhave të Falsifikuara nga Prokuroria dhe Policia e Shtetit;
 - Rritja e inspektimeve periodike dhe masave shtesë për kontrollin e operatorëve që janë identifikuar me risk nga AIF si mashtrime me kartat bankare, investime në pasuri të paluajtshme, mashtrime në Forex përmes call center, transfertat ndërkombëtare, kriptomonedha, skema investimi ose marketingu online;
 - Shkëmbimi i informacionit të mbledhur në kuadër të veprimtarisë parandaluese të Agjencisë së Inteligjencës Financiare me agjencitë ligjzbatuese kompetente për identifikimin dhe ndjekjen e rasteve të pastrimit të parave;
 - Ndarja periodike e të dhënave të platformës PRESTO mbi ecurinë e ndjekjes së rasteve të regjistruara të pastrimit të parave mes Prokurorisë së Përgjithshme dhe OPGJ dhe agjencive ligjzbatuese relevante;
 - Kryerja e inspektimeve në bazë risku për subjekte që përcakton ligji nr. 9917 datë 19.05.2008, i ndryshuar;
 - Kryerja e analizës së riskut në bashkëpunim me të gjitha instancionet përgjegjëse mbi aktivitetet kriminale që lidhen ose çojnë në pastrimin e parave dhe administrimin e të dhënave të tyre;
 - Trajnime për të rritur nivelin e ndërgjegjësimit të organeve ligjzbatuese, gjyqtarë dhe të inteligjencës për rreziqet e pastrimit të parave, me tematika të lidhura me rrezikun e mbledhjes, lëvizjes së fondeve në Shqipërisë, përdorimi i fondeve për territorin e Shqipërisë, risku nga keqpërdorimi i OJF, financimi i terrorizmit i lidhur me tregtinë etj.;
 - Analizë për nevojat e ndryshimeve ligjore për marrjen dhe përdorimin e provave elektronike.
 - Rritja e kapaciteteve të specializuara qendrore dhe vendore për hetimin e krimit ekonomik dhe financiar, përfshirë edhe kryerjen e trajnimeve të përbashkëta;
 - Konsolidimi i praktikave për aplikimin e njëkohshëm të hetimeve financiare paralele krahas hetimit penal për veprat penale të krimit të organizuar, anitrafikut dhe korrupsionit;
 - Rritja e bashkëpunimit ndërinstytucional në funksion të goditjes së korrupsionit në të gjithë format dhe nivelet e shfaqura;
 - Kryerja e hetimeve të përbashkëta me partnerët për pasuritë e fituara në mënyrë të kundërligjshme brenda dhe jashtë vendit;
 - Goditja përmes hetimeve proaktive në fushën e krimit ekonomik dhe mashtrimit financiar;
 - Sigurimi i aksesit dhe ndërveprimi online i bazave të të dhënave në funksion të mbikëqyrjes dhe hetimit në fushën ekonomike-financiare;
 - Rritja e sekuestrimeve dhe konfiskimeve të pasurive që kanë prejardhje kriminale mbështetur në hetime thelluara.

OBJEKTIVI SPECIFIK 2.4: Hetimi i krimeve kibernetike

Në përgjigje të sfidave të shumta që sjell zhvillimi i shpejtë teknologjik, si dhe përballjes me krimet kibernetike që shfrytëzojnë këto avancime për të minuar rendin dhe parimet demokratike, autoritetet ligjzbatuese duhet të jenë të përgatitura dhe të zotërojnë kapacitetet e nevojshme për të mbrojtur sigurinë kombëtare dhe rendin publik. Kjo kërkon zhvillimin dhe forcimin e aftësive teknike, ligjore dhe operacionale, si dhe investime të vazhdueshme në teknologji moderne dhe trajnime të specializuara për personelin e tyre.

Për më tepër, një nga objektivat kryesore është të krijohet dhe të përcillet tek qytetarët një ndjenjë besimi dhe sigurie në hapësirën kibernetike, duke garantuar që të drejtat e tyre digjitale dhe privatësia të mbrohen në mënyrë efektive. Kjo është jetike për ndërtimin e një mjedisi online të sigurt dhe të qëndrueshëm, ku zhvillimi teknologjik të shërbejë si një faktor për përparim dhe jo si një kërcënim ndaj rendit demokratik dhe sigurisë.

Për të arritur këto qëllime, qasja strategjike do të bazohet në implementimin e një sërë masash dhe politikash të integruara, duke përfshirë forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar, ngritjen e kapaciteteve për hetime të avancuara kibernetike, zhvillimin e legjislacionit modern dhe përmirësimin e infrastrukturës teknologjike, si dhe ndërgjegjësimin dhe edukimin e qytetarëve mbi rreziqet dhe masat e sigurisë në botën digjitale nëpërmjet;

- Përmirësimin të mbledhjes së informacionit për të luftuar krimin kibernetik, dhe krimet e lidhura me to;
- Goditjes përmes hetimeve proaktive në fushën e krimit kompjuterik/ mashtrimet që ndodhin nëpërmjet internetit;
- Përmirësimin të vazhdueshëm i historikut statistikor (track records) të goditjes së krimeve kibernetike;
- Rritjes së forcës goditëse nga ana e strukturave ligjzbatuese për gjurmueshmërinë, zbulimin, arrestimin për veprat penale në fushën kibernetike;
- Trajnimeve të vazhdueshme për punonjësit e strukturave policore mbi trendet e reja të krimit kibernetik;
- Krijimit të manualeve për operatorët privatë në lidhje me krimet kibernetike mbi format e reja të shfaqjes së tyre;
- Ndërveprimin me institucionet e tjera publike ose private, për të rritur shpejtësinë dhe saktësinë e hetimit, përcaktimin e rasteve prioritare dhe analizën e provave lidhur me rastet e abuzimit seksual të fëmijëve nëpërmjet internetit dhe teknologjive të komunikacionit;
- Konsolidimin të kapaciteteve analitike për hetimin e krimeve kompjuterike në nivel qendror bazuar në referimet e strukturave rajonale të krimit kibernetik, për identifikimin e fenomeneve apo rasteve komplekse të krimit kibernetik;
- Pajisjes së PSH-së me kapacitete laboratorike të kriminalistikës së krimit kibernetik, si në nivel qendror ashtu edhe në terren;
- Rritjes së kapaciteteve teknike për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve ndaj fëmijëve të kryera përmes internetit;

- Rritjes së numrit të reaguesve të parë të PSH-së të trajnuar ndaj abuzimit të fëmijëve në nivel Qarku;
- Ofrimit të trajnimeve lidhur me hetimin e aktiviteteve të paligjshme në fushën e kriptomonedhave;
- Rritjes së zbulimit, gjurmueshmërisë dhe ndjekjes penale të kriminelëve kibernetikë në pastrimin e parave dhe financave të paligjshme;
- Forcimit të bashkëpunimit dhe shkëmbimi i informacionit me organizata/forume dhe institucione të tjera ndërkombëtare nëpërmjet pikave të kontaktit 24/7;
- Konsolidimit dhe përmirësimit të procedurave për funksionimin e pikave të kontaktit 24/7 për hetimin e krimeve kibernetike;
- Trajnimeve të përbashkëta me agjencitë ligjzbatuese për hetimin e krimeve kibernetike dhe identifikimin e grupeve kriminale;
- Rritjes së kapaciteteve kërkimore dhe inovative në fushën e hetimit kibernetik në bashkëpunim me Akademinë e Sigurisë.

OBJEKTIVI SPECIFIK 2.5: Krijimi i një qasje strategjike për një shërbim forensik të akredituar që garanton integritetin e provës në sistemin e drejtësisë

Parashikimi strategjik i shërbimit forensik të fortë dhe të akredituar përbën një komponent kyç në garantimin e integritetit të provave brenda sistemit të drejtësisë penale. Kjo qasje mbështetet në zbatimin rigoroz të standardeve ndërkombëtare të akreditimit, siç është ISO 17025, duke siguruar kompetencën teknike, paanshmërinë dhe besueshmërinë e analizave forensike. Një strukturë e tillë përforcon transparencën institucionale dhe forcon zinxhirin e ruajtjes së provës, duke kontribuar drejtpërdrejt në legjitimitetin e vendimmarrjes gjyqësore dhe forcimin e sundimit të ligjit. Kjo synohet të arrihet zbatimit të masave si:

- Miratimi i projektvendimit "Për organizimin dhe funksionimin e institutit të Policisë Shkencore";
- Akomodimi i strukturës së Policisë Shkencore në ambjentet e reja;
- Aplikimi i standardeve minimale të cilësisë për hetimet në vendin e krimit dhe menaxhimi i provave nga vendi i krimit në sallën e gjyqit;
- Krijimi dhe funksionimi i bazave të të dhënave në fushën e të administrimit të të dhënave të ADN-së, daktiloskopike;
- Rishikimi i programit të trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm të oficerëve të Policisë Shkencore;
- Shkëmbimi i të dhënave të automatizuara në fushën e të dhënave të ADN-së dhe daktiloskopike me partneret sipas parashikimeve të Marrëveshjes PCC Prum;
- Akreditimi i shërbimeve të ofruara nga Instituti i Policisë Shkencore sipas standarteve ISO;
- Aplikimi i metodave inovative në shkencat ligjore në luftën kundër krimit të organizuar dhe veprimtarive të tjera kriminale;
- Mbështetja me kapacitete për procesin e menaxhimit të cilësisë në nivel rajonal dhe qendror;

- Krijimi i një regjistri për inventarizimin e pajisjeve duke identifikuar në mënyrë sistematike nevojat për rinovim apo zëvendësim të tyre;
- Ndërtimi i një plani investimi 1, 3 dhe 5 vjeçar për ofrimin e shërbimeve të policisë shkencore;
- Ndërtimi i Serverit Remote Control Station për krahasimin direkt të gjurmëve daktiloskopike në sistemin AFIS Papillon të Institutit të Policisë Shkencore;
- Trajnime të ekspertëve të vendit të ngjarjes;
- Trajnime mbi modelet, praktikat dhe metodat inovative të përdorura nga vendet e zhvilluara për përfshirjen në politikat e zhvillimit të kapaciteteve të shërbimit forensik.

OBJEKTIVI SPECIFIK 2.6 : Qasje strategjike mbi procesin e identifikimit, gjurmimit, konfiskimit të aseteve me prejardhje kriminale dhe ripërdorimit të tyre.

Hartimi i qasjes strategjike mbi procesin e identifikimit, gjurmimit, konfiskimit dhe ripërdorimit të aseteve me prejardhje kriminale është një komponent thelbësor në arkitekturën e politikave kundër krimit të organizuar, pastrimit të parave dhe korrupsionit. Kjo qasje synon jo vetëm ndëshkimin e aktiviteteve kriminale, por edhe goditjen e përfitimeve ekonomike që burojnë prej tyre, duke ndikuar drejtpërdrejt në dobësimin e strukturave kriminale dhe ndërprerjen e ciklit të paligjshmërisë.

Për të qenë efektive kjo qasje, është i nevojshëm ndërtimi dhe funksionimi i mekanizmave të specializuar për të bërë të mundur identifikimin dhe gjurmimin e aseteve kriminale siç është ZRA-ja, zhvillimi i hetimeve financiare paralele, forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional mes agjencive ligjzbatuese, prokurorisë, administratës tatimore dhe institucioneve të inteligjencës financiare, si dhe rritja e kapaciteteve profesionale në përdorimin e mjeteve të avancuara analitike dhe teknologjike. Një aspekt tjetër i rëndësishëm është bashkëpunimi ndërkombëtar, veçanërisht në rastet kur asetet janë të shpërndara jashtë territorit vendas, duke kërkuar mekanizma efikasë për asistencë të ndërsjellë ligjore dhe ekzekutim të vendimeve të huaja të konfiskimit.

Ripërdorimi i aseteve të konfiskuara duhet të bazohet në parime të transparencës, llogaridhënies dhe përdorimit për qëllime publike, siç janë mbështetja e viktimave, forcimi i kapaciteteve institucionale apo financimi i projekteve sociale dhe komunitare. Kjo jo vetëm rrit efikasitetin e sistemit të drejtësisë penale, por gjithashtu forcon besimin e publikut në institucionet shtetërore dhe kontribuon në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe më të qëndrueshme.

Në këtë kontekst, ky dokument strategjik ka parashikuar disa masa për realizimin e këtij objekti si vijon:

- Miratimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 44/2025 “Për Zyrën e Rekuperimit të Aseteve”;
- Pjesëmarrja e ZRA-s në Rrjetin Evropian të Zyrave të Rikuperimit të Aseteve (CARIN) si dhe në platformat rajonale/ ndërkombëtare të rikuperimit të aseteve;

- Përmirësimi i procedurës së administrimit dhe ripërdorimit të aseteve të konfiskuara me qëllim ruajtjen e vlerës dhe/ose rritjen e kësaj vlere me qëllim ripërdorimin e saj;
 - Kryerja e procedurave efikase dhe në kohë për administrimin dhe/ose ripërdorimin e saj;
 - Mundësimi i ripërdorimit të aseteve të konfiskuara, përfshirë ripërdorimin social, brenda 6 muajve nga konfiskimi;
 - Përmirësimi progresiv i historikut të sekuestrimeve dhe konfiskimeve parandaluese të aseteve, duke përfshirë konfiskimin, jo të bazuar në dënim dhe konfiskimin nga palët e treta;
 - Hartimi i praktikave unifikuese për revokimin e aseteve kriminale;
 - Identifikimin e nevojave për rritjen e kapaciteteve logjistike;
 - Hartimi i procedurave standarte të përbashkëta veprimi për bashkëpunimin midis AAPSK dhe Zyrës së Rikuperimit të Aseteve (ZRA);
 - Përmirësimi i elementeve funksionale të regjistrit elektronik të pasurive të sekuestruara/konfiskuara;
- Rritja e shkëmbimit të informacionit ndërinstitutional dhe ndërkombëtar në fushën e aseteve të sekuestruara dhe aksesit në databazat përkatëse.

OBJEKTIVI SPECIFIC 2.7: Hetimi, ndjekja penale dhe dënimi i drejtuesve dhe anëtarëve të strukturave kriminale

Krijimi i strukturave të reja të specializuara në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda përbën një zhvillim pozitiv dhe premtues për goditjen e grupeve kriminale dhe ndëshkimin e drejtuesve dhe anëtarëve të tyre. Për të siguruar rezultate të qëndrueshme dhe të prekshme në këtë drejtim, do t'i jepet prioritet rritjes së efikasitetit të hetimeve penale, me fokus të veçantë të identifikimi dhe ndjekja penale e organizatorëve dhe financuesve të veprimtarive kriminale. Kjo do të mbështetet përmes forcimit të kapaciteteve teknike, realizimit të investimeve strategjike në funksion të hetimeve të thelluara, cilësore dhe proaktive, si dhe përmirësimit të mëtejshëm të kuadrit ligjor. Synimi kryesor mbetet rritja e efektivitetit të përgjithshëm në luftën kundër strukturave kriminale të organizuara. Në këtë kontekst, për hetimin penal dhe ndëshkimin e drejtuesve dhe anëtarëve të këtyre strukturave do të zbatohen një sërë masash dhe veprimesh konkrete, të detajuara më poshtë.

- Realizimi i vazhdueshëm i track recordeve të dënimeve përfundimtare;
- Sigurimi i Aksesit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në rrjetin SIENA;
- Ngritja e kapaciteteve të përgjimit parandalues në BKH;
- Ngritja e një sistemi analize në BKH për vlerësimin e kërcënimeve në lidhje me krimin e organizuar dhe korrupsionin, në bashkëpunim me agjencitë e tjera ligj zbatuese;
- Zbatimi i regjimit të posaçëm në burgun e sigurisë së lartë, për subjektet me rrezikshmëri të theksuar kriminale, si dhe vlerësimin e klasifikimit të kategorizimit të jashtëm dhe të brendshëm dhe vlerësimit progresiv të rrezikshmërisë të këtyre subjekteve;

- Rritja e rasteve të hetimeve proaktive dhe hetimi i vazhdueshëm i tyre duke vlerësuar dhe mbledhur informacione për rastet korruptive, abuzive, veprave kriminale brenda sistemit penitenciar;
- Parandalimi dhe goditja e krimeve në IEVP-të e vendit në bashkëpunim me SPAK, Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore, si dhe agjencitë ligjzbatuese;
- Rritja e përdorimit të metodave speciale të hetimit (infiltrim, etj);
- Hartimi i marrëveshjes së bashkëpunimit mes drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për dhënien akses ZQK INTERPOL Tirana në bazën e të dhënave të personave që vuajnë dënimin në Institucionet e Ekzekutimit të Veprave Penale në Shqipëri;
- Rritja e efikasitetit të hetimeve kundër strukturave të organizuara kriminale, kryesisht të drejtuesve dhe financuesve të veprimtarive kriminale;
- Rritja e efikasitetit të bashkëpunimit me partnerët në drejtim të zbulimit të veprimtarive të paligjshme dhe goditjes së strukturave kriminale;
- Jetësimi i sistemit të INTERPOL Interpol Web Service for Data Management, (ISDM dhe shërbimin WISDM) në sistemin TIMS të Policisë së Shtetit;
- Rinovimi i pajisjes Router - VPN që vendoset në serverat e ZQK INTERPOL Tirana dhe mundëson inkriptimin e komunikimit në sistemin e INTERPOL, për të garantuar shkëmbim të sigurt të informacionit;
- Përditësimi i sistemit FIND të INTERPOL, i cili është inkorporuar në sistemin TIMS që nga viti 2009, në versionin FIND 0.4;
- Reduktimi i kërcënimeve ndaj jetës dhe shëndetit të personave (vrasjet, plagosjet e rënda);
- Rritja e hetimeve proaktive për parandalimin, gjurmimin, zbulimin dhe arrestimin e individëve dhe grupeve kriminale të përfshira në krime të rënda ndaj jetës dhe shëndetit;
- Blerje pajisje për Aplikim e identifikimit biometrik të personit LTA;
- Blerje pajisje për strukturat e policisë në luftën kunder krimit të organizuar e financiare, si dhe asistencë teknike.

OBJEKTIVI SPECIFIK 2.8: Forcimi i parandalimit, zbulimit dhe ndëshkimit të krimit mjedisor duke zbuluar grupet e organizuara në aktivitete kriminale ndaj mjedisit, si dhe uljen e ndjeshme të rasteve të ndotjes së qëllimshme, prerjes ilegale të pyjeve dhe trafikimit të mbetjeve të rrezikshme si dhe shkatërrimit të shtretërve të lumenjve.

Forcimi i mekanizmave të parandalimit, zbulimit dhe ndëshkimit të krimeve mjedisore është i domosdoshëm për mbrojtjen e ekosistemeve dhe burimeve natyrore. Përmirësimi i kapaciteteve të autoriteteve ligjzbatuese dhe përdorimi i teknologjive moderne lejon identifikimin dhe goditjen e grupeve të organizuara kriminale që veprojnë në mënyrë të paligjshme ndaj mjedisit. Këtu përfshihet ndërhyrja efektive në prerjen ilegale të pyjeve, trafikimi i mbetjeve të rrezikshme dhe shkatërrimi i habitatit natyror, si dhe forcimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore dhe organizatave mjedisore.

Në këtë mënyrë, nëpërmjet realizimit të masave, synohet ulja e ndjeshme e rasteve të ndotjes së qëllimshme, prerjes ilegale të pyjeve dhe dëmtimeve të tjera mjedisore, duke krijuar një sistem të qëndrueshëm mbikëqyrjeje dhe ndëshkimi. Kjo forcon përgjegjshmërinë ligjore ndaj shkeljeve mjedisore dhe nxit ndërgjegjësimin publik për rëndësinë e ruajtjes së ambientit. Mbrojtja e mjedisit kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror, duke siguruar mirëqenie dhe ruajtje afatgjatë të burimeve natyrore. Masat e parashikuara në këtë objektiv janë:

- Rritja e veprimtarisë zbuluese ndaj krimeve mjedisore;
- Shkëmbimi informacionit për rritjen e cilësisë së hetimeve të veprave penale që lidhen me krimet mjedisore në bashkëpunim me organet e prokurorisë;
- Trajnime të përbashkëta të punonjësve të agjencive ligjzbatuese mbi identifikimin, zbulimin dhe referimin (cilësimin) e krimeve mjedisore;
- Propozime për ndryshime ligjore në Kodin Penal me qëllim kriminalizimin e veprimtarive të tjera dëmtuese të mjedisit përafërsisht me risitë që do të sjellë direktiva e BE-së "Për mbrojtjen e Mjedisit përmes Ligjit Penal";
- Kryerja e një analize lidhur me një kategori të caktuar të krimeve mjedisore në mënyrë që të njihet si formë e krimit të organizuar;
- Krijimi i njësive të specializuar për identifikimin e krimeve mjedisore;
- Përfshirja e kurrikulave për krimin mjedisor në Shkollën e Magjistraturës me qëllim trajnimin fillestar dhe të vazhduar të magjistratëve;
- Përfshirja e kurrikulave për krimin mjedisor në Akademinë e Sigurisë.

OBJEKTIVI SPECIFIK 2.9: Kapja e personave në kërkim ndërkombëtar

Ky qëllim specifik ka të bëjë drejtpërdrejt me forcimin e bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese të vendeve partnere. Përmes trajnimeve të vazhdueshme dhe pjesëmarrjes aktive në takimet e këtij rrjeti, synohet të rritet numri i shtetasve shqiptarë dhe të huaj në kërkim ndërkombëtar që lokalizohen dhe arrestohen. Procesi i identifikimit, ndjekjes dhe arrestimit të personave në kërkim ndërkombëtar dhe kombëtar, si dhe ndëshkimi i tyre ligjor, është një element kyç në reduktimin e ndikimit dhe kërcënimeve që krimi i organizuar dhe krimet e rënda sjellin për vendin dhe rajonin në përgjithësi. Në lidhje me arritjen e rezultateve në këtë objektiv do të zbatohen masat e mëposhtme:

- Kapja dhe vënia para drejtësisë të personave në kërkim kombëtar dhe ndërkombëtar;
- Rritja e shkëmbimit të të dhënave me vendet anëtare të ENFAST, EUROPOL dhe INTERPOL;
- Rritja e numrit të shtetasve shqiptarë të lokalizuar dhe arrestuar, të cilët janë shpallur në kërkim ndërkombëtar;
- Publikimi dhe përditësimi i të dhënave të identitetit të personave më të kërkuar ndërkombëtar.

QËLLIMI I POLITIKËS III: BASHKËPUNIMI KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR

OBJEKTIVI SPECIFIK 3.1: Forcimi i bashkëpunimit policor ndërkombëtar

Forcimi i bashkëpunimit policor ndërkombëtar është thelbësor për luftën efektive kundër krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe formave të tjera të kriminalitetit që kalojnë kufijtë shtetërorë. Duke ndarë informacionin dhe burimet mes agjencive të ndryshme policore në vende të ndryshme, mundësohet një përgjigje më e shpejtë dhe më e koordinuar ndaj kërcënimeve që prekin sigurinë globale dhe rajonale. Kjo formë bashkëpunimi kontribuon gjithashtu në përmirësimin e kapaciteteve të hetimit dhe ndalimit të personave të kërkuar ndërkombëtarisht, duke përforcuar drejtësinë dhe sigurinë në nivel lokal dhe ndërkombëtar.

Për të arritur rezultate të qëndrueshme në këtë drejtim, është i domosdoshme nënshkrimi i marrëveshjet dhe protokolleve të bashkëpunimit, përdorimi i teknologjive të avancuara dhe zhvillimi i trajnimeve të përbashkëta për stafin policor. Bashkëpunimi policor ndërkombëtar do të arrihet nëpërmjet:

- Rritjes së shkëmbimit të informacionit me agjencitë ligjzbatuese të vendeve të rajonit dhe më gjerë;
- Rritjes së bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtar në hetimin e krimit të organizuar dhe në goditjen e grupeve kriminale;
- Pjesëmarrjes aktive në EUROPOL, INTERPOL dhe platformat rajonale të bashkëpunimit;
- Rritjes së numrit të operacioneve të përbashkëta policore kundër veprimtarive dhe strukturave kriminale;
- Pjesëmarrjes aktive në takimet dhe trajnimet e ENFAST;
- Rritjes së bashkëpunimit të institucioneve për mbrojtjen e mjedisit;
- Rritjes së mëtejshme e bashkëpunimit me Qendrën Evropiane të Monitorimit për Drogën dhe Varësisë nga Drogat për përmbushjen e objektivave kombëtare për fushën e drogës;
- Kryerja e analizës dhe shqyrtimi i mundësisë për anëtarësimin e Shqipërisë në "Pompidou Group";
- Ndjekja e zbatimit të detyrimeve në marrëveshjet mes autoriteteve shqiptare dhe vendeve të BE ose vendeve të treta në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda.

OBJEKTIVI SPECIFIK 3.2: Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja

Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal përbëjnë një nga format më të rëndësishme të bashkëpunimit ndërkombëtar për përballimin e sfidave që lidhen me aktivitetet kriminale dhe personat e përfshirë në to. Globalizimi dhe lëvizja e lirë e njerëzve dhe shtetasve sjellin sfida të përbashkëta në fushën e sigurisë, të cilat nuk mund të zgjidhen brenda kufijve të një juridiksioni të vetëm, duke kërkuar kështu një bashkëpunim të ngushtë ndërkufitar. Kjo strategji ka për qëllim të forcojë marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja, si një mjet

për të ndëshkuar personat që tentojnë të shmangin përgjegjësinë ligjore, si dhe për të rritur besimin reciprok me vendet partnere.

Për të arritur rezultate më të mira në drejtësinë penale kundër autorëve dhe veprimtarive të paligjshme që lidhen me krimin e organizuar dhe krimet e rënda, është e nevojshme të shfrytëzohen në maksimum instrumentet dhe mekanizmat juridikë ndërkombëtarë. Në këtë kuadër, do të ndiqen dhe zbatohet një sërë masash dhe veprimesh të përcaktuara si në vijim:

- Rritja e efikasitetit të bashkëpunimit gjyqësor për ekzekutimin e kërkesave për bashkëpunim gjyqësor ndërkombëtar nga Shqipëria apo nga shtetet e huaja;
- Përditësimi dhe aksesimi në regjistrin gjyqësor penal të shtetasve shqiptarë të dënuar jashtë shtetit;
- Mbështetja në skuadrat e përbashkëta hetimore (JIT-s dypalëshe/Eurojust).

PJESA III: ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, RAPORTIMI DHE MONITORIMI

3.1 Përgjegjësia e institucioneve

Institucionet përgjegjëse që ngarkohen për zbatimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda dhe Planit të Veprimtari janë:

1. Ministria e Punëve të Brendshme;
2. Ministria e Drejtësisë;
3. Ministria e Mbrojtjes;
4. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
5. Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit;
6. Ministria e Financave;
7. Ministria e Arsimit;
8. Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;
9. Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit;
10. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
11. Ministria e Mjedisit;
12. Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;
13. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
14. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
15. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
16. Këshilli i Lartë Gjyqësor;
17. Prokuroria e Përgjithshme;
18. Shërbimi Informativ i Shtetit;
19. Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kombëtare;

20. Agjencia e Inteligjencës Financiare;
21. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;
22. Banka e Shqipërisë;
23. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekustruara dhe të Konfiskuara;

3.2. Llogaridhënia, raportimi dhe monitorimi

Llogaridhënia

Përqasja dhe rishikimi i dokumentit Strategjik do të jetë sipas kërkesave të VKM-së nr. 290, datë 11.4.2020, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS), për të siguruar përputhshmërinë me sistemin IPSIS”. Procesi i llogaridhënies, monitorimit dhe analizës vlerësuese do të bëhet nga strukturat koordinuese si më poshtë:

Grupi i menaxhimit të integruar të politikave (GMIP);

- Komiteti Drejtues Sektorial (KDS) për çështjet e rendit dhe sigurisë publike, i cili do të shqyrtojë dhe do të miratojë raportet në zbatim të politikave dhe objektivave të përcaktuar në këtë dokument strategjik.
- Ministria e Punëve të Brendshme është institucioni përgjegjës që udhëheq hartimin, koordinimin dhe bashkërendimin e institucioneve të përfshira në këtë Strategji.

Monitorimi

Krahas zbatimit të masave të përcaktuara në Strategji dhe në planin e veprimit, monitorimi i vazhdueshëm i strukturave të angazhuara për përmbushjen e detyrimeve, që rrjedhin nga këto dokumente konsiderohet i nevojshëm për të analizuar gjendjen reale gjatë zbatimit të tyre dhe për të mbikëqyrur implementimin periodik, me qëllim përmbushjen e tyre në mënyrë sa më efektive.

Monitorimi dhe vlerësimi i punës së autoriteteve që kanë detyrime për zbatimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda do të shërbejë për të ndjekur ecurinë e Strategjisë, për të vlerësuar shkallën e realizimit të politikave, objektivave të saj dhe përmbushjes së masave dhe aktiviteteve.

Monitorimi i Planit të Veprimit do të kryhet nga grupi për menaxhimin e integruar të politikave (GMIP), të miratuar me urdhrin e kryeministrit nr. 157, datë 22.10.2018, “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”.

Procesi do të kryhet me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga institucionet kryesore përgjegjëse për çështjet e sigurisë (përfshirë MB/DPPSH, MD, MASR, MSHMS etj.), donatorë dhe shoqëria civile (përfaqësues të organizatave joqeveritare).

Me synim garantimin e përmbushjes së politikave në luftën kundër krimit të organizuar, bazuar në këtë dokument strategjik, do të merren masat e mëposhtme:

- do të monitorohen treguesit e përcaktuar në strategji;
- do të rekomandohen ndryshime në programet sektoriale, duke pasur parasysh arritjet, rrethanat, risqet dhe rreziqet, si dhe eksperiencat e mëparshme, si dhe në përputhje me rekomandimet e progresraporteve të Bashkimit Evropian;
- do të sigurohen konsultime me palët e interesit, përfshirë shpërndarjen sistematike të informacionit për publikun;
- do të jepet kontribut në rritjen e konsistencës dhe të integritetit të politikave dhe masave të sigurisë në të gjitha nivelet e administrimit, si dhe në përdorimin më të mirë të burimeve.

Monitorimi do të kryhet bazuar në raporte 6-mujore dhe vjetore për monitorimin dhe koordinimin e zbatimit të objektivave dhe masave të planit të veprimit. Përmirësimet në sistemin e monitorimit dhe vlerësimit synojnë të lehtësojnë/ndihmojnë në përafrimin e kuadrit strategjik dhe prioritetëve në fusha të ndryshme dhe të informojnë për politikën e vendit të lidhura me përballjen e sfidave kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda. Fuqizimi dhe zgjerimi i kuadrit statistikor si në MPB, DPPSH-ja dhe institucionet e tjera përgjegjëse do të lehtësojë hartimin e politikave bazuar në evidenca/të dhëna, si dhe do të mundësojë vlerësimin objektiv për përmbushjen e objektivave.

Raportimi

Të gjitha institucionet të ngarkuara me zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin dhe Luftën kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda dhe planit të veprimit do të hartojnë raporte mbi bazë 6-mujore dhe njëvjeçare në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në Planin e Veprimit në zbatim të Strategjisë, si dhe do të hedhin të dhëna në sistemin IPSIS. Ministria e Punëve të Brendshme do të jetë institucioni lider, i cili do të mbledhë, përpunojë dhe analizojë raportet periodike 6- mujore dhe 1-vjeçare që do të përcillen nga të gjitha institucionet e ngarkuara në përmbushje të objektivave dhe masave përkatëse.

Institucionet duhet të raportojnë periodikisht për realizimin e masave, me periodicitet 6-mujor përmes të dhënave të raportuara në Sistemin Informativ për Planifikimin Strategjik të Integruar (IPSIS) në Këshillin e Ministrave dhe në Sekretariatën Teknik Ndërinstitucional.

Përveç monitorimit të vazhdueshëm, progresi në përmbushjen e qëllimeve të Strategjisë Kombëtare për Parandalimin dhe Luftën kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënd do të matet nëpërmjet dy mënyrave të vlerësimit, atë të vlerësimit afatmesëm, që do të kryhet në përfundim të dyvjeçarit, në fund të vitit 2025, që do të analizojë rezultatet e arritura, menaxhimin e burimeve dhe cilësinë e zbatimit. Kjo analizë do të tregojë për ndryshimet në kontekstin e përgjithshëm ekonomik dhe social, do të vlerësojë nëse qëllimet janë të qenësishme, duke krahasuar kontekstin fillestar dhe do të identifikojë veprimet e nevojshme.

Bazuar në këtë vlerësim, do të hartohet Plan i Veprimit për vitet 2026–2028 për të arritur objektivat e vendosur në strategji.

Një vlerësim përfundimtar, pas përfundimit të periudhës së zbatimit, do të analizojë të gjithë strategjinë dhe ndikimin e saj të përgjithshëm, ku do të vlerësohen rezultatet e masave të ndërmarra, burimeve të investuara dhe masën në të cilën janë arritur efektet e pritura. Vlerësimi përfundimtar do të kryhet duke analizuar të dhënat nga burime të ndryshme, duke përfshirë edhe gjetjet e monitorimit të performancës dhe vlerësimit të ndikimit të programeve aktive në luftën kundër krimit të organizuar.

PJESA IV: ANALIZA BUXHETORE

Në këtë kre paraqitet shpërndarja e kostove treguese dhe burimet financiare për financimin e aktiviteteve të Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin dhe Luftën kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2026-2030. Kostimi i Strategjisë është realizuar duke u mbështetur në metodologjinë dhe praktikën e planifikimit buxhetor, ndërsa vlerësimi i kostove indikative është mbështetur në objektivat e përcaktuar si dhe në masat e aktiviteteve të identifikuar për secilin aktivitet. Përlllogaritjet buxhetore janë bërë duke përdorur instrumentin e rekomanduar nga IPSIS, të përshtatur sipas udhëzimeve përkatëse.

Kostoja e përgjithshme e përlllogaritur për zbatimin e **Planit të Veprimit 2026-2028, të Strategjisë Kombëtare për Parandalimin dhe Luftën kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2026-2030** është **55,091,694,337 Lekë**.

Kursi mesatar për referencë është përlllogaritur me 93.1 lekë për 1 Euro.

Tabela 1: *Kostot e përgjithshme, burimet e financimit dhe hendeku financiar gjatë periudhës kohore 2026-2030.*

Qëllimi i Politikave	i	Natyra/ Tipologjia e Kostove	Kostoja Totale	Kostot e Planifikuara	Kostot e Planifikuara	Hendeku Financiar
			2026-2028	PBA 2026-2028	PBA 2026-2028	2023-2025
				Buxheti	Donatoret	
Qëllimi i Politikës I		Korente	12,681,193,149	12,675,193,149	6,000,000	0
		Kapitale	468,287,000	468,287,000	0	
Qëllimi i Politikës II		Korente	7,798,399,066	7,796,164,066	2,235,000	0
		Kapitale	34,198,521,998	3,941,821,998	30,256,700,000	
Qëllimi i Politikës III		Korente	945,293,124	945,293,124	0	0
		Kapitale	0	0	0	
TOTALI [Leke]			56,091,694,337	25,826,759,337	30,264,935,000	0
TOTALI [Euro] 1 euro 93.1 Leke			602,488,661	277,408,801	325,079,860	0

Efektet financiare janë përlogaritur për të gjithë periudhën e zbatimit të strategjisë 2026-2030, duke mbajtur në konsideratë aktivitetet e parashikuar në planin e veprimit 2026-2028 dhe dokumentin strategjik. Efektet financiare parashikohen të përballohen nga buxhetet respektive vjetore të institucioneve të ngarkuara me zbatimin e masave, nga buxhete të donatorëve dhe institucioneve të tjera që janë ngarkuar për zbatimin e masave.


Procesi i kostimit u mbështet në konsultimin e dokumenteve të tjerë kombëtarë, përfshirë këtu Programin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027, Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe Programin Buxhetor Afatmesëm 2028-2030 dhe konsultimet me të gjitha institucionet e përfshira në zbatimin e planit, si dhe në kostot historike nga zbatimi i planit pararendës.

Plani i veprimit shoqërohet me një kostim analitik të secilës masë, i cili mbështetet nga detajimi i hollësishëm i shpenzimeve për çdo aktivitet. Kostimi i strategjisë dhe planit të veprimit është realizuar në bazë të metodologjive dhe praktikave së planifikimit buxhetor, duke përdorur instrumentet e rekomanduar nga IPSIS.

Grafiku 1: *Financimi i strategjisë do të realizohet nga disa burime duke përmendur këtu buxhetin e shtetit (46%) dhe financim të huaj (54%). Hendeku financiar është 0%.*

	LEK		EURO
Kostot Totale të PV	56,091,694,337	%	602.488,661
PBA 2026-2028	25,826,759,337	46	277,408,801
Financimi I Huaj	30,264,935,000	54	325,079,860
Hendek financiar 2026-2028	0	0	0
Kosto Korente	21,424,885,339	38	220,492,861
Kosto kapitale	34,666,808,998	62	372,360,999
Total kosto	56,091,694,337	%	602.488,661

Grafiku nr. 2: Paraqitja grafike e kostove të planit të veprimit të strategjisë duke evidentuar ndarjen e shpenzimeve me financim nga Programi Buxhetor Afatmesëm dhe me financim të huaj



Grafiku nr. 3: Paraqitja grafike e natyrës së kostove ekonomike të strategjisë dhe të planit të veprimit duke evidentuar ndarjen në kosto korente dhe kosto kapitale



Kostot korente zënë rreth 38% të shpenzimeve totale, ndërsa kostot kapitale zënë rreth 62%.

Për masat të planit që janë të pambuluara financiarisht për periudhën 2026-2028, institucionet përgjegjëse do të planifikojnë nevojat për financime buxhetore nëpërmjet programeve buxhetore përkatëse, si pjesë e procesit të planifikimit të programit afatmesëm buxhetor dhe buxhetit vjetor, si dhe do të negociojnë me donatorë të ndryshëm për t'i bashkëfinancuar disa aktivitete.

Strategjia është fokusuar kryesisht në ndjekjen penale dhe goditjen e krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, e cila evidentohet edhe në paraqitjen e mëposhtme grafike ku qëllimi i politikës II zë peshën më të lartë specifike në totalin e kostos së planit të veprimit të kësaj strategjie.

Grafiku nr. 4: Paraqitja grafike e ndarjes së kostove sipas qëllimeve të politikave

Kosto të lidhura me qëllimet e politikave

